



Trebeshina



VITI XXVI

Nr. 108

GUSHT 2026

Drejtor: **Bashkim BRAHIMI**

Kryeredaktor: **Veledin DURMISHI**

Çmimi: 50 lekë

PRONONCIM PUBLIK i Shoqatës Atdhetare Kulturore “Tafil Buzi”

Shoqata Atdhetare Kulturore “Tafil Buzi”, duke përfaqësuar një pjesë të konsiderueshme të komunitetit dhe të territorit të Bashkisë Memaliaj, shpreh shqetësimin dhe kundërshtimin e saj ndaj propozimit për shkrirjen e Bashkisë Memaliaj dhe bashkimit të saj me Bashkinë Tepelenë, në kuadër të reformës së re administrativo-territoriale.

Ne besojmë se çdo reformë administrative duhet të mbështetet mbi analiza të thelluara, konsultim të gjerë me komunitetin dhe respektim të identitetit historik, kulturor dhe shoqëror të zonave që preken prej saj. Çdo vendimmarrje që anashkalon zërin e banorëve dhe të organizatave që i përfaqësojnë ata rrezikon të cenojë besimin e qytetarëve ndaj institucioneve.

Bashkia Memaliaj nuk është thjesht një njësi administrative. Ajo përfaqëson një histori, një identitet të ndërtuar ndër breza, një trashëgimi të pasur kulturore dhe atdhetare, si dhe një komunitet që ka kontribuar me dinjitet në zhvillimin e vendit.

Në vitet e fundit, Bashkia Memaliaj ka shënuar zhvillime të dukshme në përmirësimin e infrastrukturës, në zgjerimin e shërbimeve publike, në gjallërimin e jetës sociale e kulturore dhe në promovimin e vlerave historike e turistike të zonës. Këto arritje dëshmojnë se kjo bashki ka potencial zhvillimi dhe nuk duhet të penalizohet me një vendim që mund të ngadalësojë këtë ritëm dhe të zbehë përfaqësimin e komunitetit të saj.

Shoqata Atdhetare Kulturore “Tafil Buzi”, e cila ushtron veprimtarinë e saj në më shumë se gjysmën e territorit të Bashkisë Memaliaj, e konsideron këtë bashki si një hapësirë me vlera të veçanta historike, kulturore dhe njerëzore, që meriton të ruajë statusin dhe funksionimin e saj administrativ.

Ne u bëjmë thirrje institucioneve përgjegjëse që, përpara marrjes së çdo vendimi, të zhvillojnë konsultime të hapura me qytetarët, pushtetin vendor, organizatat e shoqërisë civile dhe të gjitha grupet e interesit, duke dëgjuar me seriozitet argumentet dhe shqetësimet e komunitetit.

Qëndrimi ynë nuk është kundër reformave dhe as kundër zhvillimit. Përkundrazi, ne mbështesim çdo ndryshim që sjell më shumë efikasitet, më shumë zhvillim dhe më shumë mirëqenie për qytetarët. Megjithatë, jemi të bindur se zhvillimi nuk arrihet duke zbehur identitetin dhe përfaqësimin e komuniteteve lokale, por duke i forcuar ato.

NË UDHËT E NJË JETE TË TRAZUAR

-Kushtuar Nevruz
Ismail Taraj-



Nga Feti Zeneli

Faqe 3

MJEKUT IDAJET DURA QË I PATI HIJE DHE DUK SAKRIFICA



Nga Veleddin Durmishi

Faqe 2

PROMOVOHET MONOGRAFIA “KOPSHTINA JONË – SELCKA E MADHE”



Nga Shoqata Atdhetare
Kulturore
“Tafil Buzi”

Faqe 7, 8

PËR NJERIUN QË I KIShte LEZET FJALA



Nga Asim Brahimi

Faqe 6

NDEROHET PATRIOTI BIDO SHALËSI



Nga avokat Rushit Demo,
Doktor i shkencave juridike.

Faqe 5

KOMARI – FSHATI KU ZEMRAT BRAHIN NJËSOJ PËR VENDLINDJEN



Nga Margarita Pashaj

Faqe 6,8

NJË DEDIKIM MIRËNJOHËS NGA SHOQATA JONË PËR KONTRIBUTIN E ENKELEIDA FEJZOS NË DITËLINDJEN E SAJ



Portretizim shumëngjyror i Enkeleida Zenjel Fejzo

Enkeleida Zenjel Fejzo ka lindur në 8 gusht 1977 në Memaliaj. Ka përfunduar arsimin e mesëm në shkollën e mesme të përgjithshme “Sali Nivica” në Memaliaj. Mandej vijoi studimet e larta në Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Fakulteti i Shkencave Sho-

qërore (Cikli i Ulët), të cilin e përfundoi në vitin akademik, duke u titulluar: “Mësuese për Ciklin e ulët”.

Si rrjedhojë e dashurisë për rritjen e nivelit të saj arsimor lufton e përkushtuar në edukimin dhe kualifikimin e saj: merr Titullin: “Mar-

vijon në faqen 7

Portret

MJEKUT IDAJET DURA QË I PATI HIJE DHE DUK SAKRIFICA



Nga Veleddin Durmishi


Venë nga venë, por të gjithë lumenjtë derdhen në det. Kjo setencë e ardhur nga kohët më erdhi si pa kujdesin tim të shtuar në kujtesë, ndërsa përpara kisha një mjek të cilin as emrin nuk ia kisha dëgjuar, veçse pak ditë më parë, kur ai u shfaq në celularin tim nga kryetari i shoqatës sonë, Bashkim Brahimi. Një emër i panjohur, një njeri që zotërohej nga një qetësi apostolike e për më tepër një kthjelltësi në arsyetim e që shpesh sikur pengohet diku, duke kërkuar të fitojë pak qetësi. Vinte e nga nuk vinte biseda, por gjithnjë kthehej në vendlindjen e tij, atje në Gllavën e Vogël e së tepërmi te babai i tij i cili sot është 93 vjeç. Mjeku Idajet Dura tashmë ndihet i plotësuar. Por, nëse do të më duhej një personazh, një model, ku sakrifica ka një emër e mbiemër për t'u shfaqur me tërë madhështinë e bukurinë e vet, duhet të jetë pranë emrit të këtij njeriu. Pëlqen së tepërmi krenarët që kanë edhe arsye për të qënë të tillë, por nuk i do, madje i përbuz të krekosurit dhe mburraveçet. Ai ka shumë për të folur. Një jetë plot sakrifica, privime, por në fund ia arriti falë dashurisë për profesionin, dëshirës superiore për të dëshmuar vlerat më qënësore që e dallojnë një mjek e për më tepër ndershmërinë, ai tregues që sot shoqëria e vë me një pikëpyetje prapa çdo njeriu që ka një detyrë. Ai kujton me nostalgji fëmijërinë e vet tepër të vështirë deri në dhimbje. Tetë fëmijë, pesë djem e tri vajza e fëmijëria e atyre viteve ishte një sfidë jete. Babai vuante nga stomaku e djali i tij i madh, Idajeti, e shihte me aq dhimbje babanë e vet tek mblidhej një grusht nga dhimbja kronike e stomakut. Punonte në minierë, ushqimi po dihej, të ftohtë, puna në galeri dhe babai shpesh shkonte

në Memaliaj te mjeku i minatorëve i cili vetëm i jepte ndonjë qetësues, ndërsa babai mblidhej krupull, në minderin e varfër me kashtë të shtëpisë së tij. Djali shtrëngohej e vetëtimthi i vinte një mendim se sikur të ishte mjek do ta shëronte babanë që vuante, veç halëve të shumta të jetës, edhe fukarallëkun, edhe pasojat e një fakti historik që sikur e ndiqte pas si një hije, Dy xhaxhallarët e tij kishin qënë ca muaj me ballin. Hej, bela! Idajeti mbaroi klasën e tetë në shkollën e Izvorit me rezultate shumë të mira, por nuk shpresonte për ndonjë



bursë. Ato dihehin; ishin së pari në dispozicion të të privilegjuarve të shoqërisë, njerëzve me parti e pushtet, por drejtori i shkollës, Gani Bega, i sugjeroi babait që djalin të mos ta shpjerë në ndonjë dyvjeçare, sepse jeta e tij aty mbyllej, ndërsa djali premonte për më tej e më tutje. Dhe vërtet kështu ndodhi. Djali i dhanë një shkollë teknike për murator në Elbasan ku me një valixhe druri babai e shpuri në shkollën e re, me shpresë për të marrë një degë tjetër. Por nuk mundi. U kthye në shtëpi djali dhe një javë nuk doli nga shtëpia sepse i vinte turp që mbeti pa shkollë, apo me keq e kishin përzënë nga shkolla. Por Izvori aty ishte, aty poshtë fshatit të tij, aty ku mbaron edhe Lugina e Luftinjës. Dhe aty mbaroi shkollën djali nga Gllava e vogël i mbushur me ca shpresa të cilat aty-këtu edhe i fikeshin nga ajo drejt biografi që nuk u ndahej si hija e tyre e mallkuar. Dhe kërkesa për shkollimin e mëtejshëm u ndërtua atë verë kur mbaroi shkollën e mesme bujqësore. Ai kërkoi për agronom dhe për mësues i biologjisë dhe kimisë. E harroi dëshirën fillestare për mjek, edhe pse babai vuante sërisht, e sërisht te mjeku e sërisht mblidhej një grusht nga dhimbjet e stomakut. Dhe atë verë bëri

një foto me një shokun e tij në Tepelenë- këtu nënqeshi Idajeti. Fotografi në bisedë e sipër, pasi mësoi jetën e fëmijëve që prisnin përgjigjet e atij gushti për një shkollë të lartë, e kur Idajeti i thotë se ai mund të shkonte për mjekësi, (më pëlqeu të mburresha pak, thotë në bisedë tani ai) atëherë fotografi qeshi pak hidhur duke i thënë; - ti për mjekësi, ti ballisti nga Gllava, e për më tepër je edhe nga Gllava e vogël!!! Heshti një hop Idajeti e më tej vijoi rrjedhën e atij fundgushti. Në komitetin ekzekutiv të rrethit ishte një bursë



për mjekësi dhe kishte një grindje për njeriun që do ta fitonte atë të drejtë. Ishin dy kandidatūra e kur sherri arriti në majë, kryetari i komitetit që ishte Hasan Musta, vuri veton duke pyetur: -kush është tjetri në listë me rezultate të mira? Përgjigjia erdhi nga përgjegjësi i arsimit i cili tha se është një djalë nga Gllava, një farë... Idajet Dura (për fat nuk tha që është me blanjë në biografi) Dhe në çast kryetari vendosi: - ky djalë le të shkojë për mjekësi! E ja tani Idajeti kryqëzoi krahët duke thënë se fati ishte në anën time, se sëmundja e babait që mua më torturonte në çdo çast të ditës, më kishte shtyrë deri te ëndrra ime për t'u bërë mjek. E sigurisht pacienti i parë do të ishte babai.

Kjo ishte beteja e parë e një të riu që ai sot, pas kaq vitesh, pranon qetësisht se fati ishte në anën e tij. Ai atë vjeshtë do të nisej drejt Tiranës për të ndjekur një shkollë që në ato kohë ishte si një "mollë e ndaluar" për një kategori nxënësish që, edhe pse ishin me nota të mira, ishin të privuar. Gjithnjë me këtë ide e kishte ushqyer veten. E shumta mund të ishte nesër një agronom, por mjek, kurrsesi! Por fati të ndjek edhe pse ti nuk je në anën e tij. Këtu mjeku Idajet Dura qëndroi një hop. Ishte

plotësisht i zotëruar nga një qetësi, nga një kënaqësi që, ndërsa shkarkonte gjithë kujtesën e vet, ndihet se rruga e tij kishte qënë një sfidë e madhe, jo për ato vite pune në Shqipëri, por, kur ai vendosi të shkojë drejt Greqisë. Kjo ishte vërtet një sipërmarrje e vështirë të cilën e përballoi vetëm me punë e ndershmëri.

Mbaroi mjekësinë e përgjithshme dhe atë vit e emëruan mjek në Peshkop, në kuadër të ndihmës së asaj zone që vuante nga mungesa e mjekëve, por edhe e profesioneve të tjera. Djali i ri tepelenas mjek në Muhur. (1987-1992). Të parën herë që djali u kthye në vendlindje, pasi kishte marrë detyrën si mjek në Veri, i solli babait ilaçet e duhura kundër sëmundjes së stomakut. Efekti ishte i shpejtë. Babai u shërua plotësisht. Gjithë drojë, besonte te aftësitë e veta teorike, por të prekje pacientin e parë e të përcaktoje



Gjatë një vizite në vilën "Sofia" në Gllavë

diagnozën që do ta shëronte pacientin, nuk ishte e lehtë. Ai flet tërë respekt e mirënjohje për atë zonë, për ata njerëz që kishin edhe humor, por ishin aq bujarë në mikpritjen e tyre. (Doktor, mua më dhembnin kryet e ti me shpon te të ndenjatur) Aty gjithçka tregonte varfërinë, I ka bërë përshtypje kujdesi i -paktë i qytetarëve ndaj shëndetit të tyre e për më tepër edhe ndaj fëmijëve që i vishnin shumë keq. Ai ndihet i kënaqur nga puna e atyre viteve në Peshkop. Ishte një zonë me 5 000 banorë. Ishin dy mjekë, pranë kishin edhe një minierë mermeri e Idajeti mendon se asnjëherë nuk ka refuzuar një vizitë. Gjithnjë i gatshëm, natën e ditën në verë të nxehtë e në borë janari, mjeku i ri me

atë çantë e me pak ilaçe në të, rendte nga fshati në fshat, gjithnjë në shërbim të jetës. Aty mjeku i ri u dashurua me një kolege, një infermiere nga Kukësi e aty u lindi edhe një fëmijë. Pesë vjet ishte detyrim i tij dhe pas pesë vjetësh ai kërkon të kthehet në Tepelenë apo edhe në Tiranë. Por kërkesa e tij u refuzua tërësisht. Tani emërimi i ri ishte në Kavajë. Një mjek me gjithë familje paraqitet në Kavajë pas një përvoje pesë vjeçare në Peshkop. Këtu iu nënshtrua një specializimi dyvjeçar për infeksionet e vaksinat.

Ndryshimet politike në Shqipëri erdhën vrullshëm shpesh edhe përtej pritshmërive. Korniza e ngjarjeve ishte tërësisht e paqartë. Shumë shpejt u pa dukshëm se demokracia ishte një përrallë joshëse. Fajdetë që po lindnin si kërpuhat pas shiut, rrënuan atë ekonomi të vogël që shqiptarët po hidhnin me aq përpjekje e dhimbje. Erdhën të nxituara reformat që rrënuan edhe ekonominë e trashëguar nga socializmi. Filluan lëvizjet demografike në Shqipëri të cilat ishin aq kaotike. Mjekun tepelenas në Kavajë e quanin nën zë si "komunist" dhe nga kjo ai vuante shumë. Mban mend një sëmundje që quhej "kolerë" e që përfshiu Shqipërinë e Mesme në vitin 1994. Një epidemi që zgjati gjashtë muaj. Pati shumë viktima. Një sëmundje që vinte nga mung-



esa e higjienës e nga niveli i ulët i mirëqënies. Shteti u mobilizua tërësisht. U kalua ai moment, por Idajeti ishte ende pa shtëpi në

vijon në faqen 5

NË UDHËT E NJË JETE TË TRAZUAR

-Kushtuar Nevruz Ismail Taraj-



Nga Feti ZENELI

Jeta e Nevruz Ismail Tarajt nga fshati Komar përbën shumë më tepër se historinë personale të një njeriu; ajo është një dëshmi e gjallë e fatit të një brezi të tërë shqiptarësh, të cilët u rritën mes varfërisë, shpresës, sakrificës dhe përmbyesjeve të mëdha historike që tronditën botën gjatë gjysmës së parë të shekullit XX. Në këtë udhëtim njerëzor ndërthuren ëndrrat e rinisë, dashuria për dijen, sprovat e luftës, drama e mërgimit dhe triumfi moral i një njeriu që nuk reshti kurrë së qëndruari besnik ndaj vetvetes. Siç shprehej filozofi romak Seneka: “Nuk është se kemi pak kohë për të jetuar, por humbasim shumë prej saj”. Dhe Nevruzi ishte një nga ata njerëz që e mbushën kohën e tyre me përpjekje, punë, dinjitet dhe përvojë, duke e shndërruar jetën në një udhëtim të pasur me kuptim.

Ai lindi në vitin 1919, në një kohë kur bota ende po përpigëj të shëronte plagët e thella të Luftës së Parë Botërore. Europa numëronte humbjet e saj, ndërsa Shqipëria, ende një shtet i ri dhe i brishtë, përpigëj të konsolidonte institucionet, të forconte identitetin kombëtar dhe të hidhte themelet e një të ardhmeje më të sigurt. Në këto rrethana të vështira, në Komarin e vendosur mes kufijve natyrorë të krahinave të Tepelenës dhe Beratit, erdhi në jetë një djalë, për të cilin i ati, Ismail Taraj, ushqente një ëndërr të madhe: ta arsimonte. Në atë kohë, ky nuk ishte një synim i zakonshëm. Alfabetizimi mbizotëronte në pjesën më të madhe të vendit, sidomos në zonat e thella rurale, ku fati i fëmijëve lidhej pothuajse tërësisht me bujqësinë dhe blegtorinë. Shkolla konsiderohej një privilegj i rrallë, ndërsa dija mbetej ende një derë e hapur vetëm për pak njerëz.

Por Ismaili kishte kuptuar një të vërtetë të madhe, të cilën e kishte përkufizuar edhe Francis Bekon me shprehjen e tij të famshme: “Dija është fuqi”. Ai e kishte kuptuar se pasuria materiale mund të humbiste, tokat mund të ndry-

shonin pronar e të ndaheshin, kohërat mund të ndryshonin, por dija mbetej pasuria e vetme që askush nuk mund t’ia rrëmbente njeriut. Pikërisht për këtë arsye, ai nuk kurseu as mundin, as sakrificat dhe as rrjetin e miqësive që kishte ndërtuar ndër vite. Duke shfrytëzuar besimin që gëzonte në komunitet, u përqopq t’i hapte të birin dyert e arsimit në një kohë kur rrugët mateshin me ditë të tëra ecjeje, ndërsa largimi i një fëmije nga shtëpia përbënte një sakrificë të madhe familjare. Hapat e parë të dijes Nevruzi i hodhi në Buz Kalemaj, vendlindjen e kapëdanit të njohur shqiptar Tafil Buzi. Aty u strehua në familjen e Faik Kapuas, pasardhës i një dere me tradita të spikatura atdhetarie.

Për një djalosh të ardhur në një mjedis tjetër, largimi nga ngrohtësia e familjes në moshë të njomë përbënte një sprovë më vete.

Ndërsa Nevruzi lexonte, mësonte dhe formësonte personalitetin e tij, përtej kufijve të Shqipërisë po grumbulloheshin re të reja kërcënuese. Kriza e madhe ekonomike botërore e viteve 1929-1933 kishte tronditur themelet e ekonomive më të fuqishme të kohës, duke ushqyer pakënaqësi shoqërore, nacionalizma agresivë dhe ambicie pushtuese që shumë shpejt do ta shtynin njerëzimin drejt një katastrofe të re.

Megjithatë, për një të ri si Nevruzi, përfundimi i shkollimit përfaqësonte fundin e një etape dhe nisjen e një tjetre, të mbushur me ëndrra, shpresa dhe plane për të ardhmen. Ai mendonte të rikthehej në Komar, pranë familjes, për të kontribuar në ekonominë vetjakë dhe për ta vënë dijen e fituar në shërbim të komunitetit të tij.

Ashtu si shumë bashkëmoshatarë të brezit të vet, besonte se pas viteve të vështira të krizës ekonomike, njerëzimi do t’i rikthehej qetësisë dhe normalitetit. Por historia, shpeshherë, nuk pyet për planet e njerëzve. Siç shkruante Tolstoi: “Njerëzit mendojnë se e ndryshojnë historinë, por shpesh historia është ajo që i ndryshon njerëzit”.

Dhe historia kishte përgatitur për Nevruzin një sfidë të re. Më 7 prill 1939, pushtimi italian i Shqipërisë do të trondiste themelet e jetës kombëtare dhe do të shembte shumë nga ëndrrat e rinisë shqiptare. Një realitet i trishtë, i mbushur me pasiguri, detyrime dhe sfida të panjohura, do të hynte me forcë në jetën e tij.

Kështu do të niste kapitulli më i trazuar i ekzistencës së Nevruzit; ku jeta personale do

të ndërthurej pazgjidhshmërisht me ngjarjet e mëdha të historisë botërore. Në këtë periudhë, ai kishte hyrë në dekadën e tretë të jetës. Ishte njëzet vjeç, në atë moshë kur njeriu fillon të ndërtojë të ardhmen dhe të projektojë ëndrrat e veta. Mirëpo, si mijëra të rinj të brezit të tij, nuk do të ishte më zot i plotë i fatit të vet. Ngjarjet historike do të ndërhyjnë me forcë në rrjedhën e jetës së tij, duke e futur në një realitet krejtësisht të paparashikuar. Pushtimi italian nuk ndryshoi vetëm fatin politik të Shqipërisë, por edhe jetën e përditshme të qytetarëve të saj. Një brez i tërë të rinjsh u përfshi në mekanizmat e administratës së re, e cila, ndonëse ruante formalisht emrin e institucioneve shqiptare, zbatonte urdhrat e pushtuesit.

Në këtë vorbull zhvillimesh u gjend edhe Nevruzi. Duke qenë në moshën e detyrimit ushtarak, ai iu përgjigj thirrjes për të kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak, duke u integruar në strukturat ushtarake të organizuara sipas modelit italian. Fillimisht shërbeu në Ersekë dhe më pas në Lezhë. Për Nevruzin, kjo nuk ishte një zgjedhje politike, por një etapë e imponuar nga koha, të cilën ai u përqopq ta përballonte me seriozitet, disiplinë dhe ndershmëri. Shumë shpejt u vu re se zotëronte aftësi që e veçonin nga shumica e bashkëmoshatarëve të tij. Arsimimi i fituar në vitet e rinisë, kultura administrative, shkrimi i rregullt dhe përdorimi i makinës së shkrimit e bënë një element të vlefshëm për organizimin e punëve të repartit. Për këtë arsye, atij iu besuan detyra administrative që kërkonin korrektësi, përgjegjësi dhe besueshmëri.

Në pamje të parë, ishte një punë larg zhurmës së armëve dhe përplasjeve të drejtpërdrejta të luftës. Por koha do të dëshmonte një të vërtetë të hidhur: në periudhat e mëdha të përmbyesjeve politike, njerëzit shpesh nuk gjykojnë për atë që kanë bërë, por për rrethanat në të cilat i ka vendosur historia. Ndërkohë, Lufta e Dytë Botërore po zgjerohej me shpejtësi në të gjitha drejtimet. Ballkani po shndërrohej në një arenë ku përplaseshin interesa të shumta politike, ushtarake dhe strategjike.

Edhe trojet shqiptare jashtë kufijve administrativë të kohës po përjetonin transformime të mëdha.

Në fillim të vitit 1943, Nevruzi u transferua në Kosovë, ku shërbeu në Prizren, Pejë, Gjakovë dhe Prishtinë. Kjo përvojë i dha mundësinë të njëjhte me nga

afër realitete të ndryshme shoqërore, njerëzore dhe kulturore, duke zgjeruar edhe më tej horizontin e tij jetësor. Por lufta nuk prodhon vetëm betejat dhe fitore ushtarake. Ajo mbjell gjithashtu varfëri, uri, pasiguri, sëmundje dhe vuajtje të panumërta njerëzore.

Siç shkruante Ernest Heminguei: “Kur më mos mendoni se lufta, sado e nevojshme të duket, nuk është krim.”

Pikërisht në ato vite, Kosova u përfshi nga një epidemi e rëndë e tifos së zorrëve, e cila preku qindra banorë dhe ushtarake. As Nevruzi nuk mundi t’i shpëtonte kësaj fatkeqësie. Teksa ndodhej në spitalin e Prishtinës u njoh me Rana Fanën nga Vlora, një vajzë e re, pjesëtare e Brigadës së Pestë Sulmuese, e cila ndodhej në gjendje të rëndë shëndetësore. Përtej bindjeve politike, uniformave apo vijave ndarëse që krijon lufta, Nevruzi pa tek ajo vetëm njeriun që kishte nevojë për ndihmë. Ai iu gjend pranë, e mbështeti dhe e ndihmoi në ditët më të vështira, duke dëshmuar se humanizmi është vlera më e lartë që i mbijeton çdo konflikti dhe çdo ideologjie.

Ndërkohë, lufta po i afrohej fundit, por një tjetër realitet po lindte. Një realitet më i heshtur, më i ndërlikuar dhe shpesh më i ashpër në gjykimet e veta. Shqipëria po hynte në epokën e përmbyesjeve të mëdha ideologjike, ku kufiri mes fajit dhe pafajësisë, mes detyrimit dhe zgjedhjes personale, do të bëhej gjithnjë e më i paqartë.

Sepse lufta që po përfundonte në fushëbeteja shumë shpejt do të zëvendësohej nga një luftë tjetër, shumë më e heshtur dhe më e gjatë: lufta për të mbrojtur emrin, dinjitetin dhe vetë të drejtën për të jetuar i lirë në vendin e tij.

Me kapitullimin e Italisë fashiste, më 9 shtator 1943, edhe Nevruzi vendosi t’i jepte fund angazhimit të tij ushtarak dhe të kthehej në Komarin e dashur, aty ku e prisnin prindërit, shtëpia dhe rrënjët e tij. Ishte një rikthim i mbushur me emocione të forta. Familja e tij kishte jetuar për vite me radhë nën peshën e ankthit, pa ditur nëse djali i tyre do të kthehej ndonjëherë shëndoshë e mirë. Për këtë arsye, ardhja e Nevruzit u përjetua si një bekim i vërtetë.

Në të njëjtën kohë, edhe Komari kishte hyrë në një realitet të ri politik. Fryma e organizimit nacionalçlirimtar kishte depërtuar në fshat dhe ishte krijuar Këshilli Nacionalçlirimtar, në krye të të cilit ishte zgjedhur Ismaili, babai i Nevruzit. Kjo përbënte një dëshmi të qartë të besimit që

komuniteti kishte tek ai, por edhe të prestigjit që familja Taraj gëzonte në zonë.

Për Nevruzin, kthimi në shtëpi simbolizonte mundësinë për të filluar një jetë të re. Ai vazhdonte ta shihte të ardhmen të lidhur me profesionin ushtarak dhe ushqente dëshirën për t’u bërë oficer, duke vënë në shërbim të vendit disiplinën, përvojën dhe njohuritë e fituara ndër vite. Megjithatë, si në çdo familje shqiptare, edhe brenda mureve të shtëpisë së tyre bashkëjetonin këndvështrime të ndryshme. Babai i tij, i kalitur nga përvoja dhe urtësia e jetës, nuk i imponoi asnjë vendim. Ai besonte se djali tashmë kishte arritur moshën e pjekurisë dhe duhej ta ndërtonte vetë të ardhmen e tij. Ndërsa e ëma, me zemrën e ndjeshme të çdo nëne shqiptare, e shihte luftën si një humnerë të pafund rreziqesh dhe dëshironte ta mbante pranë familjes, larg stuhive që ende nuk kishin pushuar.

Por historia nuk kishte ndërmend ta linte Nevruzin të jetonte një jetë të qetë. Pak kohë më vonë, në gazetatat e kohës u botua një njoftim që u kërkonte të gjithë atyre që kishin shërbyer më parë në ushtri apo në xhandarmëri të paraqiteshin në Ministrinë e Mbrojtjes në Tiranë. Po krijoheshin strukturat e reja ushtarake dhe shumë të rinj duhej të përcaktonin vendin e tyre në realitetin e ri që po lindte. Nevruzi vendosi të nisej drejt kryeqytetit i shoqëruar edhe nga bashkëmoshatarë i tij, Njazi Tafil Agaj.

Të dy u nisën herët në mëngjes, të pajisur me pak gjëra materiale, por me shumë shpresa për të ardhmen. Në çantat e tyre ndodheshin disa ushqime të përgatitura me dashuri nga duart e nënave dhe një besim i heshtur se po ecnin drejt një etape të re të jetës. Pikërisht gjatë këtij udhëtimi do të shfaqej edhe një herë fisnikëria e rrallë e karakterit të Nevruzit. Kur arritën në Fratar, u përballën me një ushtar italian të mbetur pas kapitullimit të ushtrisë së tij. I rras-kapitur, i uritur dhe i braktisur nga gjithçka që deri pak kohë më parë dukej e pathyeshme, ai i lutej kalimtarëve për një copë bukë. “Çe pane, çe pane, prego!”, përsëriste ai me zë të dridhur. Pa asnjë hezitim, Nevruzi hapi çantën dhe i dha gjysmën e kulaçit që ia kishte përgatitur e ëma. Ishte një gjest i thjeshtë, por me një domethënie të jashtëzakonshme. Në një kohë kur lufta kishte ndarë njerëzit në anë të kundërta, ai zgjodhi të mos shihte armikun, por njeriun e

vijon në faqen 4

NË UDHËT E NJË JETE TË TRAZUAR

vijon nga faqja 3

uritur. Ky ishte një nga tiparet që do ta shoqëronte gjatë gjithë jetës së tij: aftësia për të mos e humbur kurrë njerëzoren, edhe kur rrethanat përpiqeshin ta shuanin atë ndjenjë fisnike. Filozofi kinez Konfuci ka thënë: “Njerëzillëku është virtyti më i madh që mund të zotërojë njeriu”. Dhe Nevruzi e mishëronte pikërisht këtë virtyt.

Pasi mbërritën në Fier dhe më tej në Tiranë, rrugët e dy miqve u ndanë. Novruzi u regjistrua në Brigadën e Pestë Sulmuese, ndërsa Njaziu mori një drejtim tjetër.

Gjurmët e këtij angazhimi ruhen edhe sot në dokumentacionin e Arkivit të Ushtrisë, si dëshmi e një etape të rëndësishme të jetës së tij. Në Brigadën e Pestë u vu nën drejtimin e Shefqet Peçi dhe gjeti pranë vetes edhe bashkëkrahinorin Enver Malasi. Por një nga takimet më prekëse do të ishte ai me Rana Fanën. Sapo e pa, ajo e përqafoi me mall dhe i tha: “Vëlla, edhe ti këtu!” Ishte ribashkimi i dy njerëzve që kishin ndarë vuajtjet e sëmundjes dhe që tani po takoheshin sërish në një tjetër kthesë të historisë. Megjithatë, Nevruzi vazhdonte të mbannte brenda vetes një shqetësim të vazhdueshëm. Ai druhej se shërbimi i mëparshëm në strukturat ushtarake të kohës së pushtimit mund të keqinterpretohej dhe të kthehej në shkak paragjykimi. Rana u përpoq ta qetësonte. Ajo i kujtoi se vlera e një njeriu nuk përcaktohet nga rrethanat ku e vendos historia, por nga qëllimet, veprat dhe kontributi që ai jep në shërbim të njerëzve.

Pikërisht për këtë arsye, aftësitë e tij administrative u vunë në shërbim të brigadës dhe atij iu besua detyra e intendentit. Edhe babai i tij, Ismaili, shkoi ta takonte në Kosovë.

Në atë takim të shkurtër, por të mbushur me mençurinë e një jete të tërë, i dha një këshillë që do ta shoqëronte për shumë kohë: të mos shkëputej nga rrjedha fituese e kohës, sepse zhvillimet politike po tregonin qartë se Partia Komuniste po konsolidonte gjithnjë e më tepër pushtetin e saj.

I prekur nga përkujdesja prindërore, Nevruzi vendosi t’i bënte një dhuratë të atit.

Me kursimet e tij, i bleu një kostum, një palë çizme dhe një palë këpucë italiane, si shenjë mirënjohjeje për njeriun që kishte sakrifikuar aq shumë për arsimimin dhe të ardhmen e tij. Sepse, siç thoshte Ciceroni: “Mirënjohja nuk është vetëm virtyti më i madh, por edhe nëna e të gjitha virtyteve të tjera.”

Ndërkohë, lufta vazhdonte rrugëtimin e saj të përgjakshëm. Ai do ta kujtonte gjithmonë përballjen e parë me

gjermanët si një nga momentet më tronditëse të jetës.

Në errësirën e natës, plumbat filluan të çanin ajrin mbi kokat e luftëtarëve. Për herë të parë, ai ndjeu sa i brishtë është kufiri që ndan jetën nga vdekja. Për një çast, kur ktheu kokën, pa se shokët e tij ishin tërhequr. Duke u zvarritur mes frikës dhe instinktit të mbijetesës, arriti t’i gjente të strehuar në një përrua. Ishte një përvojë që nuk do ta harronte kurrë. Sepse lufta, përtej parullave dhe idealeve, mbetet gjithmonë një përballje e drejtpërdrejtë e njeriut me kufijtë e vet.

Por ndërsa fundi i luftës po afrohej, në shpirtin e Nevruz Ismail Tarajt po lindte një ankth i ri. Ai filloi të kuptonte se sfida më e madhe e jetës së tij nuk do të vinte më nga një ushtri e huaj, por nga realiteti i ri politik që po merrte formë brenda vetë Shqipërisë. Në një klimë ku dyshimi po zëvendësonte besimin, ku biografitë individuale po gjykoreshin sipas rrethanave historike dhe jo sipas qëllimeve të njerëzve, e ardhmja e tij po bëhej gjithnjë e më e paqartë. Ndonëse nuk kishte kryer asnjë vepër të dënueshme, nuk kishte tradhtuar vendin e tij dhe nuk i kishte shkaktuar padrejtësi askujt, mbi jetën e tij po rëndonte hija e paragjykitimit politik.

Shërbimi i detyrueshëm që kishte kryer gjatë viteve të pushtimit, i imponuar nga rrethanat historike dhe jo nga bindjet ideologjike, rrezikonte të interpretohej ndryshe nga pushteti i ri që po konsolidohej. Përballë kësaj situatë, ai mori një nga vendimet më të dhimbshme që mund të marrë një njeri: të largohej nga Shqipëria.

Jo sepse nuk e donte vendin e tij, por pikërisht sepse dëshironte të ruante jetën, dinjitetin dhe të drejtën për të jetuar i lirë. Kështu nisi një tjetër udhëtim i gjatë, ndoshta më i vështiri i gjithë ekzistencës së tij: udhëtimi i mërgimit.

Nuk ka plagë më të heshtur sesa ajo e largimit nga vendlindja. Njeriu mund të marrë me vete pak sende, disa kujtime dhe një grusht fotografish, por zemrën e lë gjithmonë pas, aty ku ka hedhur hapat e parë të jetës. Sepse siç shkruante poeti libanez Kahlil Xhibran: “Shtëpia nuk është vendi ku jeton trupi, por vendi ku pushon zemra”.

Rruga e arratisjes kaloi përmes viseve të Maqedonisë, nëpër Qafë Thanë, rrëzë Malit të Thatë, për të vazhduar më tej drejt Bilishtit e më pas përtej kufirit shqiptar. Ishte një udhëtim i mbushur me ankth, pasiguri dhe me ndjenjën e rëndë të ndarjes nga gjithçka që kishte qenë deri atëherë jeta e tij. Ai po linte pas shtëpinë,

prindërit, vendlindjen, fëmijërinë dhe kujtimet e rinisë, pa e ditur nëse një ditë do të kishte mundësinë t’i shihte përsëri. Fillimisht u vendos në kampin e refugjatëve në Pire të Athinës, ku kaloi rreth një vit në kushte të vështira jetese. Ashtu si mijëra emigrantë politikë të asaj periudhe, ai u përball me vetminë, pasigurinë dhe sfidën e mbijetesës në një vend të huaj. Por Nevruzi ishte nga ata njerëz që nuk e lejonin fatkeqësinë t’i mposhte. Ai i përkiste asaj kategorie që, edhe kur jeta u mbyll në derë, kërkonjë me durim një shteg tjetër për të ecur përpara, pasi për ta: “Suksesi nuk është përfundimtar, dështimi nuk është fatal; rëndësi ka guximi për të vazhduar”, siç thoshte Çurçill. Dhe Nevruzi vazhdoi, duke kaluar në Bari të Italisë, ku kushtet e jetesës ishin disi më të favorshme. As atje nuk qëndroi duarkryq. Filloi të ndiqte kurse të gjuhës angleze, duke e konsideruar dijen si çelësin më të sigurt të integrimit.

Në mendjen e tij po merrte formë një ëndërr e re: emigrimi drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës, vendit që për miliona emigrantë simbolizonte mundësinë e një fillimi të ri.

Edhe pse larg atdheut, ai nuk reshti kurrë së investuari tek vetja. Sepse e kishte kuptuar një të vërtetë universale, të cilën Benjamin Franklin e kishte përmbledhur me fjalët: “Investimi në dije sjell gjithmonë interesin më të madh”. Pas një periudhe qëndrimi në Itali, rrugët e jetës e çuan në Hamburg të Gjermanisë, ku jetoi për tetë vite me radhë. Ishin vite të mbushura me punë, sakrifica dhe përpjekje të pandërprera për të ndërtuar një të ardhme të sigurt larg atdheut.

Më në fund, fati i buzëqeshi. Me ndihmën e mikut të tij, Hamit Begea, i cili jetonte në Nju Jork dhe mori përsipër ta garantonte, Nevruzi arriti të emigronte në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Një kapitull i ri i jetës po hapej përpara tij. Ashtu si shumë emigrantë të brezit të vet, ai nuk kërkoj rrugë të shkurtra, privilegje apo favore. Filloi nga puna e ndershme. Punoj në profesione të ndryshme, duke u mbështetur vetëm te forca e karakterit, këmbëngulja dhe ndershmëria e tij. Gradualisht arriti të ndërtojë biznesin e vet privat dhe të sigurojë një jetë të qëndrueshme ekonomike, fryt i punës së palodhur dhe i sakrificave shumëvjeçare. Historia e tij u bë një shembull i asaj që mund të arrijë njeriu kur refuzon t’u dorëzohet vështirësive. Ndaj s’u dorëzua kurrë.

Megjithatë, edhe përtej oqeanit, hijet e Luftës së Ftohtë vazhdonin të ndiqnin

jetët e emigrantëve shqiptarë. Në një moment të caktuar, atij iu kërkuar të përfshihej në aktivitete spiunazhi kundër Shqipërisë komuniste. Përgjigjja e tij ishte e prerë dhe e palëkundur. Ai refuzoi kategorikisht. Nuk pranoi të përdorej si instrument politik kundër vendit ku kishte lindur. Për të, Shqipëria nuk identifikohet me një regjim të caktuar politik, por me tokën, gjuhën, njerëzit dhe kujtesën e tij shpirtërore. Edhe pse ishte larguar prej saj, nuk mund të pranonte të bëhej pjesë e asnjë veprimi që do të dëmtonte atdheun e tij. Kjo ishte ndoshta dëshmia më e pastër e karakterit të tij.

Ai u largua nga Shqipëria, por atdheu nuk u largua kurrë prej tij. Siç ka shkruar Ismail Kadare: “Atdheu është ai që njeriu e mban brenda vetes, kudo që të shkojë.”

Nga largësia e kontinentit amerikan, Nevruzi vazhdoi ta ndiqte me vëmendje fatin e Shqipërisë dhe zhvillimet e mëdha që po trazonin botën. Me interes të veçantë vështronte ndryshimet që po ndodhnin në Europën Lindore, duke ushqyer brenda vetes bindjen se asnjë regjim, sado i fortë të duket, nuk është i përjetshëm.

Ai besonte se koha është gjykatësi më i drejtë i historisë dhe se e vërteta, sado gjatë të mbulohet, një ditë gjen rrugën për të dalë në dritë. Edhe Nevruzi ishte ndër ata njerëz që nuk e humbën kurrë besimin tek rrjedha natyrore e historisë.

Rënia e sistemit komunist në Bashkimin Sovjetik dhe valët demokratizuese që përfshinë vendet e Europës Lindore i rizgjuan shpresën që e kishte mbajtur gjallë për dekada të tëra. Më në fund, ajo ditë që kishte jetuar për aq shumë vite në mendjen dhe zemrën e tij erdhi. Në shtator të vitit 1991, pas afro gjysmë shekulli mërgimi, Nevruz Ismail Taraj u rikthye në Shqipëri. Ishte rikthimi i një njeriu që kishte përshkuar tri kontinente, kishte njohur luftën, emigracionin, pasigurinë, ringritjen dhe triumfin e vullnetit njerëzor, por që nuk e kishte humbur kurrë lidhjen shpirtërore me vendlindjen e vet. Ai nuk u kthye me ndjenja hakmarrjeje, as me mllef për padrejtësitë e përjetuara, por me dashurinë e pakushtëzuar të njeriut që e kishte ruajtur atdheun si një thesar të shenjtë brenda zemrës së tij.

Në kujtesë mbante fëmijërinë e Komarit, sakrificat e prindërve, vitet e rinisë, plagët e historisë dhe mallin e grumbulluar gjatë dekadave të gjata të largësisë.

Sepse malli për vendlindjen nuk plaket kurrë. Ai jeton bashkë me njeriun deri

në frymën e fundit. Nevruzi vërtetë kishte jetuar në vende të ndryshme, kishte njohur kultura të shumta dhe kishte ndërtuar mirëqenie materiale, por identiteti i tij kishte mbetur i pandryshuar. Ai mbeti deri në fund djali i Komarit. Sepse rrënjët e njeriut nuk maten me largësinë gjeografike, por me thellësinë e lidhjes shpirtërore që ai ruan me vendin ku ka lindur. Në Shqipërinë e transformimeve demokratike ai gjeti një vend të ndryshuar, por njëkohësisht edhe të njëjtin vend që kishte mbajtur gjallë në kujtesën e tij për dekada me radhë. Ndoshta jo gjithçka ishte ashtu siç e kishte ëndërruar, por vetë fakti që mund të ecte lirshëm në tokën e vet përbënte një fitore të madhe morale.

Në fund të fundit, liria është një nga dhuratat më të çmuara që mund t’i jepet njeriut. Filozofi francez Zhan Zhak Ruso shkruante: “Njeriu lind i lirë, por kudo gjendet i lidhur me zinxhirë”. Nevruzi i kishte njohur të gjitha format e këtyre zinxhirëve: luftën, paragjykimin, mërgimin, vetminë dhe pasigurinë. Megjithatë, ai nuk lejoi kurrë që ato ta thyenin shpirtërisht. Pas katërmëdhjetë vitesh të jetuara në Shqipërinë demokratike, Novruz Ismail Taraj u nda nga jeta, duke mbyllur një udhëtim të jashtëzakonshëm njerëzor që kishte nisur në Komarin e vogël të vitit 1919 dhe ishte shtrirë përmes luftërave, kufijve, kontinenteve dhe sistemeve të ndryshme politike.

Por jeta e njerëzve si ai nuk matet me numrin e viteve që jetuan. Ajo matet me gjurmët që lanë pas. Dhe gjurma e Nevruzit mbetet ajo e një njeriu të ditur, punëtor, fisnik dhe human, i cili gjatë gjithë jetës u përpoq të mbetej besnik ndaj ndërgjegjes së tij, pavarësisht stuhive të historisë që u përpoqën vazhdimisht t’ia ndryshonin fatin.

Në fund të fundit, jeta e tij dëshmon një të vërtetë të madhe njerëzore: njeriu nuk e zgjedh epokën në të cilën lind, por zgjedh mënyrën se si do ta përballojë atë.

Dhe Nevruz Ismail Taraj zgjodhi ta përballonte me dinjitet. Kjo është ndoshta trashëgimia më e bukur që ai la pas. Një trashëgimi që nuk ndërtohet mbi pasuri materiale, por mbi virtytet që i mbijetojnë kohës: dashurinë për dijen, humanizmin, ndershmërinë, punën, mirënjohjen dhe besnikërinë ndaj atdheut.

Dhe pikërisht për këtë arsye, historia e Nevruz Ismail Tarajt nuk mbetet thjesht historia e një njeriu, por shndërrohet në historinë e një brezi të tërë shqiptarësh, të cilët, mes stuhive të shekullit XX, ditën të mbeteshin njerëz.

NDEROHET PATRIOTI BIDO SHALËSI



**Nga avokat Rushit Demo,
Doktor i shkencave juridike.
Nip i personazhit të këtij
shkrimi**

Një ditë e veçantë për familjen tonë, por edhe për kujtesën historike të kombit shqiptar. Ditën e enjte, më 23 korrik 2026, Këshilli Bashkiak i Memaliajt, me propozimin e Shoqatës Kulturore-Atdhetare “Tafil Buzi”, i akordoi titullin “Qytetar Nderi” patriotit dhe luftëtarit të shquar të çështjes kombëtare, Bido

Ismail Shalësi (1883–1960).

Në emër të familjes sonë, si pasardhës të Bido Ismail Shalësit, shpreh mirënjohjen më të thellë për këtë vlerësim. Sot nuk nderohet vetëm kujtimi i një patrioti; sot nderohen idealet e lirisë, të pavarësisë dhe të shtetformimit, për të cilat ai jetoi dhe sakrifiko për më shumë se katër dekada.

Falënderoj Kryetarin e Bashkisë Memaliaj, z. Albert Malaj, Kryetarin e Këshillit Bashkiak, z. Erjon Sinanaj, të gjithë anëtarët e Këshillit Bashkiak, si dhe në mënyrë të veçantë z. Petrit Lumani, z. Bashkim Brahimi dhe z. Qamil Xhelili, për mbështetjen dhe angazhimin e tyre në realizimin e këtij vlerësimi.

Ky është një vlerësim i vonuar, por i drejtë. Drejtësia historike, edhe kur vjen vonë, mbetet drejtësi.

Për më shumë se 40 vjet,

Bido Ismail Shalësi luftoi me armë në dorë kundër pushtuesve osmanë, grekë, austro-hungarezë dhe italianë, si komandant i Çetës së Buzit, përkrah figurave më të shquara të Rilindjes Kombëtare dhe Pavarësisë



së Shqipërisë. Ai mori pjesë në Shpalljen e Pavarësisë, në Luftën e Vlorës dhe në

shumë beteja të tjera vendimtare për fatet e kombit shqiptar.

Në dëshmitë e tij, ai shkruante:

“Kam marrë pjesë aktive në shërbim t’Atdheut... për çështjen e shenjtë të idesë nacionaliste të kombit shqiptar... jemi kalbur në burgjet e atëhershme duke shkruar atë pak pasuri që kishim trashëguar prej të parëve tanë, me ngushëllimin e një mendimi: që një ditë Shqipëria të gëzonte lirinë.”

Megjithëse kontributi i Bido Ismail Shalësit në luftërat për lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë ishte jashtëzakonshëm, për shumë dekada emri dhe vepra e tij mbetën në harresë. Pas vendosjes së regjimit komunist, ai u shpall “armik”, ndërsa familja e tij u përball me persekutim politik. Djali i tij u dënua me

vdekje nga regjimi për motive politike. Këto rrethana bënë që një pjesë e rëndësishme e historisë së tij të lihej në heshtje për shumë vite.

Prandaj, ky vlerësim nuk është vetëm një nderim për një patriot të shquar, por edhe një akt i rivendosjes së së vërtetës historike. Shoqëritë demokratike kanë detyrimin të nderojnë të gjithë ata që i shërbyen kombit, pavarësisht bindjeve politike apo fatit që u rezervoi historia.

Sot, me këtë nderim, hidhet një hap i rëndësishëm drejt rivlerësimit të një figure kombëtare, e cila ia kushtoi jetën lirisë dhe pavarësisë së Shqipërisë.

Lavdi veprës dhe kujtimin të përjetshëm të Bido Ismail Shalësit. Kujtesa për njerëz të tillë është pjesë e identitetit dhe dinjitetit të kombit shqiptar.

MJEKUT IDAJET DURA QË I PATI HIJE DHE DUK SAKRIFICA

vijon nga faqja 2

Kavajë. Mjeku që i gëzohej vetëm rrogës, nuk kishte dot mundësi financiare të blinte një shtëpi, qoftë edhe në Kavajë. Nuk abuzoi kurrë me detyrën. Detyrën e quante përgjegjësi morale, ngarkesë psikologjike të cilën mjeku duhet ta ketë të shenjtë e ndërtimi i kësaj ngrehine kërkonte forcë, kurajo, dinjitet që te mjeku duhet të jenë në shkallën më superiore. Është një mekanizëm të cilin njerëzit e këtij profesioni, duhet ta kenë në shkallën më të lartë e kjo i bën ata të jenë më të besuarit përballë pacientit që te mjeku sheh edhe jetën e tij. E në këtë pikë mjeku Idajet Dura, ishte në kuotat maksimale. Ndërkohë edhe vëllai tjetër e fitoi një bursë për mjekësi, por u penalizua. Dy mjekë në një familje, jo, jo, ai u bë oficer e vëllai tjetër ekonomist të cilët në situatën e re sulmuam kufijtë Jugorë duke u sistemuar në Greqi. Dhe një ditë erdhi ftesa nga vëllezërit: - Eja në Greqi, profesioni yt nuk të lë jashtë rradhëve të bluzave të bardha! Dilema ishte hamletjane. Pagjumësia filloi. Hamendësimet si para një bote të panjohur. Greqia me atë alfabet ciri-

lik e bënte atë gjuhë aq të vështirë, Greqia nuk e njeh diplomën tonë, pastaj atje racizmi kishte dëshmuar shfaqjet e veta shpesh edhe të frikshme. Por vendimi u mor. Një vizë për në Greqi dhe mjeku Idajet Dura zbriti në Athinë ku e prisnin dy vëllezërit e tij. Më tej! Një botë e re në të cilën ai nuk hidhte dot asnjë hap. Asnjë derë nuk i shfaqej kund. Bashkëshortja grindej me veten, por edhe me bashkëshortin se na more në qafë. Çfarë do të bëjmë? Ku do të punojmë, Fëmijët (tashmë edhe me një vajzë) po rriteshin. Rendi nëpër të njohur. Bëri kërkesa pas kërkesash për të filluar në sistemin shëndetësor, por pengesat ishin të mëdha dhe shpesh atij i bëheshin mal. Pengesa e parë gjuha. Filloi të mësojë greqisht. Iu miratua një kërkesë për një ndihmësmjek në një spital të Athinës, Një rast i mirë të cilin ai nuk e la t’i ikte duarsh. Iu përkushtua gjuhës, vetëm për një fjalë në greqisht “episqesi” punoi një ditë nëpër fjalorë pa mundur dot të gjejë kuptimin e saj. Dikush ia tha që do të thoshte “ndalim urine”. Në vitin 2009 iu njoh diploma duke dhënë edhe provime suplementare. Në vitin 2014

mori nënshtetësinë greke. Më pas gjashtë vjet specializim për mushkëritë. Kaluan 16 vjet deri sa mjeku shqiptar që ishte përballur me vështirësi të mëdha, me sfida edhe tej mundësive të njeriut, pra Idajeti, mundi të dalë tej sfidave të kohës e të fitojë një vend pune në një spital të mirë të Athinës, në një spital ushtarak. Ai tregon për punën, gatishmërinë, përkujdesjen që ka treguar në kohën e kovidit, ku mjeku Idajet Dura u vu tërësish në dispozicion në shqiptarëve që i trokisnin në derë. Telefoni i tij nuk pushonte kurrë. Ai rendte nga njëri shqiptar te tjetri duke i shpëtuar nga thonjtë e vdekjes patriotët e vet të vyer e të lodhur nga sfidat e jetës. 16 vjet sakrificë, përballje me sfidat, me mentalitetin. Sado e gjatë të jetë nata, dita do ta arrijë. Dhimbja, rakrifica e bëjnë njeriun krenar, sepse është dëshmi e qënies, e ekzistencës që në emër të saj duhet çdo sakrificë. Jeta pa sakrificë e ka humbur thelbin e saj. Një herë, ndërsa punonte në ndërtim, pronari, kur mori vesh se ai djali atje me një kazëm në dorë është një mjek në Shqipëri, bëri kryqin duke vështruar qiellin e thirri

“panagjija mu!” Mjekët e Shqipërisë punëtor krahu në Greqi! Po, por përkohësisht. Sa mësues, oficerë, specialistë bujqësie i përzuri atdheu i tyre, nuk hapi punë për krahët e punës, mbylli mjaftë institucione e shqiptarët, me torbën e emigrantit supit, morën udhët e hidhura të kurbetit. Po nuk shkuan për të vdekur. Jeta për ta ka qënë një sfidë të cilën ata e kaluan me sukses. Në detyrën e mjekut ai dëshmon dhjetra raste ku përkushtimi i tij ka dëshmuar vlerat më të qënësishme të cilat e mbajtën këtë njeri në hullinë ku dinjiteti, përkushtimi e ndershmëria ishte treguesit më superior të këtij njeriu i cili mësime të parëve të vet i kishte si dritën te sytë e tij. -Në spitalin e Gjirokastrës - thoshte një paciente, - mjekët lëvizin vetëm kur u thua nga dy a tri herë, ndërsa këtu është krejt ndryshe. Një grua nga Progonati e cila u ekzaminua me sëmundje të keqe e nuk mbijetoi dot u thoshte të vetëve në telefon se këtu ndodhet një mjek nga Tepelena që më është gjendur më shumë nga vëllai im!

Venë nga venë, por të gjithë lumenjtë derdhen në det. Me këto fjalë fillova këtë

shkrim duke portretizuar një mjek “sui generis” njeri, një mjek i përkushtuar për të qënë deri në fund i mposhtur nga dinjiteti, e ndershmëria, pra, ky njeri çdo vit e prek visin e vet, visin që e rriti dhe e formësoi me ato cilësi të cilat e mbajtën gjallë e tërë dinjitet në të gjitha kohët. Ditë me parë ai ishte në biznesin e Et’hem Bajramit në Gllavë dhe shumë njerëz të zonës ishin tani pacientë të tij. Tashmë djali i tyre nuk është ai mjeku i brishtë që i dridhet dora kur prek një pacient, i dridhen gishtat kur shkruan një recetë. Por zotëron gjithçka të vetën deri në perfeksion. Jo vetëm për mushkëritë është një specialist i dorës së parë, por edhe për ato të infeksionit. Përvoja e madhe në spitalet e Athinës i ka dhënë atij atë fill sigurie e cila e bën Idajetin një mjek shembullor. Vështirë mund të gjeshe një të dytë që të ketë bërë një sakrificë të tillë. Ai e kishte lexuar se e ardhmja është e atyre që digjen, jo e atyre që ngrohen, se sakrifica shpërblen ndjekësit e saj. Dhe sot ai bën një bilanc jete dhe pa atë drojë që e ka çdo njeri, mendon se ja vlejti gjithë ajo sakrificë. Sikur më të bukur e ka bërë ajo. Së pari shpirtërisht.

KOMARI – FSHATI KU ZEMRAT RRAHIN NJËSOJ PËR VENDLINDJEN

Nga Margarita Pashaj

Një homazh për njerëzit, traditën dhe “Takimin e brezave”, 8 gusht 2026

Ka fshatra që njihen për bukuritë e natyrës, ka të tjerë që njihen për historinë e tyre, por ka edhe fshatra që mbeten të pavdekshëm falë njerëzve të tyre. Një prej tyre është Komari, një fshat i vendosur mes maleve madhështore, ku përballë ngrihen krenarë Tomorri, Trebeshina dhe Shëndëllia, si tre rojtarë të përhershëm të kësaj toke të bekuar.

Ka një ditë në vit kur koha duket sikur ndalet. Është 8 gushti. Dita kur Komari nuk është më thjesht një fshat i qetë mes kodrave, por shndërrohet në një vatër të madhe kujtimesh, emocionesh dhe dashurie për vendlindjen.

Nga çdo cep i Shqipërisë e nga shumë vende të botës nisen bijtë dhe bijat e Komarit. I thërret një zë që nuk shuhet kurrë – zëri i vendlindjes. Rruga drejt Komarit është vetë një udhëtim kujtimesh. Kalon Sahatin, Gurrazin, Kalibaqin, Osmanajt, Minajt dhe, sa më shumë afrohesh, aq më fort rreh zemra, sepse para syve shfaqet vendi i bekuar – Sheshi i Teqesë.

Ky shesh nuk është thjesht një hapësirë. Ai është krenaria e Komarit, një vepër e ndërtuar me kontributin e çdo familjeje, me mund, djersë dhe dashuri për fshatin. Muajt e fundit, kjo dashuri mori formë konkrete. Lista e kontribuesve është dëshmia më e bukur se Komari di të bashkohet kur bëhet fjalë për vendlindjen. Por, përveç

kontributit financiar, pati edhe një kontribut që nuk matet me para. Ai matet me djersë, me lodhje, me përkushtim dhe me zemër.

Për gati tre muaj me radhë, tre djem të mrekullueshëm u bënë fryma e kësaj pune: Adi Ramiz Allkushi, Gjergji Novruz Pasha dhe Reshat Fuat Bakiaj. Ata nuk numëruan orët, nuk pyetën për vapën, për lodhjen apo për sakrificat. Çdo mëngjes dhe çdo mbrëmje ishin aty, duke punuar me duart e tyre, me përkushtim dhe me një dashuri të pashoqe për Komarin. Nuk kërkuan as duartrokitje e as lavdi. Punuan në heshtje, sepse besonin se vendlindja nuk ndërtohet me fjalë, por me vepra. Në këtë kontribut të çmuar me punë vullnetare u bashkuan edhe Erjon Fetah Shahaj dhe Fatjon Halim Isufi, duke dhënë kohën, mundin dhe energjinë e tyre për të mirën e përbashkët. Edhe puna e tyre është pjesë e asaj historie të vogël, por të vyer, që u shkrua me duar të palodhura në Sheshin e Teqesë. Pas tyre qëndruan edhe dhjetëra bashkëfshatarë të tjerë, të cilët kontribuuan me zemërgjerësi për këtë vepër të përbashkët. Secili, sipas mundësive, dha një pjesë nga vetja për Komarin. Pikërisht ky unitet është pasuria më e madhe e këtij fshati.

Një mbrëmje ku gëzimi u përzie me mallin

Kulmi i kësaj atmosfere ishte “Takimi i Brezave”, më 8 gusht 2026, një ditë që do të mbetet gjatë në kujtesën e çdo komarjoti. Afërsisht 500 bijë e bija të fshatit u rikthyen në vendlindje për të ndarë mallin, kujtimet

dhe krenarinë e përbashkët.

Në këtë ditë u takuan e u përqaftuan banorët e të gjitha lagjeve të Komarit: Lilaj, Brahimaj, Xhemaliaj, Tarashanjë, Osmanaj, Minaj, Llanaj, Çunaj dhe Haxhiajt. Secila lagje mbart historinë e saj, traditat e bukura, mikpritjen, bujarinë dhe fisnikërinë që e kanë bërë Komarin të njohur ndër breza. Shumë prej banorëve të këtyre lagjeve sot jetojnë në qytete të ndryshme të Shqipërisë, ndërsa të tjerë në vende të largëta të botës. Megjithatë, as vitet, as largësia nuk e kanë zbehur lidhjen me vendlindjen. Kur vjen 8 gushti, të gjithë ndjekin të njëjtën rrugë, rrugën që të çon në Komar.

Gjatë ditëve të zakonshme, rrugët e fshatit janë të qeta, oborret të heshtura dhe shumë porta hapen vetëm në stinën e verës. Por në ditën e Takimit të Brezave gjithçka merr jetë. Rrugët mbushen me hapa, sheshi me zëra, softrat me miq, ndërsa zemrat mbushen me mall, nostalgji dhe respekt. Dhe ishte pikërisht kjo përzierje e gëzimit me mallin që i dha kësaj mbrëmjeje një bukuri të veçantë. U dëgjuan të qeshura, urime e këngë, por pati edhe shumë çaste heshtjeje, kur një kujtim i largët, një emër i dashur apo një fytyrë që nuk është më mes nesh sillte lot në sytë e atyre që ishin mbledhur aty.

Përqaftimet zgjatën më shumë se fjalët. Lotët e mallëngjimit u përzierën me buzëqeshjet e takimit. Në ato çaste, dukej sikur koha kishte bërë një hap pas dhe kishte rikthyer për pak çaste fëmijërinë, prindërit, gjyshërit, miqtë dhe njerëzit e dashur që i përkasin historisë së çdo familjeje komarjote.

vijon në faqen 8

Këngë për Komarin

Nga Abaz Taip Bakia

Që nga Argjentina
Në Komar vajte qëndrove.
Vendin tënd të lindjes
Xhelo Bektashin nderove.

Komari në Tepelenë
Ka nxjerrë njerëz të ndërë.
Inteligjentë dhe punëtorë
Por ka nxjerrë edhe shenjtorë.

Islam, Reshat, Abedinë,
Alife Xhelo florin.
Që të gjithë pasurinë
E shkrinë për bektashinë.

Ngrite teqe dhe tylbe
Që të gjithë janë atje.
Fanar për historinë,
Për ata që venë e vijnnë.

Alife, prehu i qetë
Se misionin e mbarove.
Jo vetëm krahinës tënde
Por bektashizmin e nderove.

Ne që po këndojmë këtu
Jemi nipërit e tu.
Sa fisi yt të rrojë
Brez pas brezi do të kujtojë.

Përkujtimore për Veledin Izet Mahmutaj

Për njeriun që i kishte lezet fjala

Nga Asim Brahimi

Në takime midis shokësh apo miqsh të ndryshëm krahinorë dhe jo vetëm, biseda në forma nga më të ndryshmet, drejtohet edhe atje ku siç thotë populli: “Ku dhëmb dhëmbi vete gjuha” te trashëgimnia jonë kulturore e shpirtërore e brenda saj te ata që e bartin apo ishin shquar për to. Të tilla krahina jonë ka shumë, pa i trajtuar ata për momentin, të përkujtojmë dikë në dhjetë vjetorin e ikjes nga jeta. Veledin Izet Mahmutaj, një ndër burrat më të mënçur, më atdhetarë, punëtor e mbi të gjitha bir i denjë rabiut, djalë, baba dhe gjysh i përmalluar i familjes së nderuar të Izet Mahmu-

taj. Në biseda të ndryshme, ata që e kanë njohur dhe që kanë jetuar e punuar me të, flasin për njeriun e mrekullueshëm, familjarin model, prindin e përsosur, gjyshin fjalëmbël e të përgjësuar, burrin e mënçur, mikun e rrallë, shokun zemërbardhë e besnik, bashkëqytetarin e sërës së parë. Në jetëgjatësinë e tij iu desh të ruante vlera dhe traditat më të mira të familjes, vendlindjes së tij të dashur, Rabijes edhe cilësive të larta të krahinës sonë të nderuar. Atij iu desh të punonte herë në fshat e herë në minierën e qymyrit në Memaliaj e kudo ka dëshmuar ndershmëri, përkushtim e besim te e mira, te e drejta, te e vërteta duke vlerësuar se me djersën e ballit do t’i bënte nder



jetës dhe familjes që krijoi në vendlindjen e tij që si e thotë poeti rabiut:

“Në vend me forcë tërheqëse
Nga e gjithë njerëzia.
Mekamin dhe burimin
I ka bekuar Perëndia”

Me bashkëshorten, Hatemen, krijuan familjen dhe rritën shtatë filiza pasardhës të fisit të tyre për të cilët u

përgjësua si një hero biblik me qëllim që ata të rriteshin të lumtur dhe të bdërtouni jetën ashtu si donte dhe ëndërronte ai. Dhe ashtu ndodhi. Ata u rritën, u edukua, krijuan familje dhe sot ajo celulë e vogël është bërë një brigadë me intelektuale të fushave të ndryshme si ekonomistë, inxhinierë, sipërmarrës etj. Dhe që japin ndihmën e tyre në vendet e punës sipas vlerave më të mira të trashëguara nga gjysh Velua.

I përkushtuar për familjen, i dalluar në punët e fshatit e në minierë, në sektorin e naftës, Velua ishte një aktivist i devotshëm i shoqërisë në veprimtari të ndryshme. Ai kreu me shumë përgjegjësi detyrën e kryetarit të këshillit të fshatit në vitet

’60-’64.

Edhe pse ai nuk është sot mes nesh dhe njerëzve të tij të dashur, të gjithë ne, dhe veçanërisht “mjalti i mjalit” të “kosheres” së tij do të lënë modele frymëzimi dhe edukimi për rrugëtimin e tyre të ardhshëm. Sot ndiejmë së brendëshmi atë ndjesinë që të jep kujtesa për një njeri të mirë, duke shprehur edhe një herë atë mirënjohje që njerëz si Veledini e kanë merituar gjatë gjithë jetës, madje edhe sot kur ai nuk është më mes nesh. Nderimi për të është respekti që ne tregojmë për veten duke u dhënë njerëzve me vlera të spikatura respektin që ata meritojnë. Dhe shoqëria jonë di ta japë këtë respekt. Mirënjohje pa fund për Veledin Mahmutajn!

PROMOVOHET MONOGRAFIA “KOPSHTINA JONË – SELCKA E MADHE”, NJË VEPËR QË I SHËRBEN HISTORISË DHE IDENTITETIT TË KRAHINËS

Nga Shoqata Atdhetare Kulturore “Tafil Buzi”

Në një atmosferë dinjitoze, të mbushur me emocion, respekt dhe vlerësim për historinë e trashëgiminë kulturore, Shoqata Atdhetare Kulturore “Tafil Buzi” organizoi ceremoninë e promovimit të monografisë “Kopshtina jonë – Selcka e Madhe”, me autor z. Feti Zeneli. Veprimtaria u shndërrua në një festë të kulturës, kujtesës historike dhe identitetit krahinor, duke mbledhur rreth vetes personalitete të jetës akademike, kulturore, institucionale dhe qytetare të shumtë.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin Prefekti i Qarkut Tiranë, z. Shkëlqim Hajdari, Kryetari i Bashkisë Memaliaj, z. Albert Malaj, akademiku Hamit Kaba, Kryetarja e Komitetit Kombëtar të Veteranëve, znj. Vera Tarifa, Sekretari i Përgjithshëm i këtij komiteti, z. Veli Myftari, si dhe studiues, poetë, artistë, intelektualë e përfaqësues të institucioneve të ndryshme.

Me pjesëmarrjen e 129 të ftuarve, aktiviteti dëshmoi interesin e madh që zgjojnë botimet kushtuar historisë



vendore dhe ruajtjes së kujtesës kolektive.

Veprimtarinë e hapi Kryetari i Shoqatës “Tafil Buzi”, z. Bashkim Brahimi, i cili përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se misioni i shoqatës mbetet promovimi i historisë, kulturës dhe traditave të krahinës, si një detyrim ndaj brezave që kanë kontribuar në ndërtimin e identitetit tonë kombëtar.

Vlerat e monografisë u analizuan nga historiani Prof. Dr. Shyqyri Hysi, politologu Myzajlen Hoxha dhe Prof. Asoc. Sazan Guri, të cilët e cilësuan librin si një kontribut me rëndësi të veçantë në dokumentimin e historisë së Selckës së Madhe. Në referimet e tyre u theksua puna kërkimore e autorit, pasuria dokumentare e veprës dhe rëndësia e saj për studiuesit, brezat e rinj dhe çdo lexues të interesuar për historinë e kësaj treve.

Një moment artistik mjaft emo-

cionues solli aktori Viktor Aliu, i cili interpretoi pjesë të zgjedhura nga monografia, duke përcjellë tek të pranishmit frymën dhe mesazhin që mbart kjo vepër.

Me fjalët e tyre përshëndetëse, Prefekti i Qarkut Tiranë, z. Shkëlqim Hajdari, dhe Kryetari i Bashkisë Memaliaj, z. Albert Malaj, vlerësuan autorin dhe Shoqatën “Tafil Buzi” për kontributin e vazhdueshëm në ruajtjen e trashëgimisë historike dhe



kulturore, duke theksuar se botime të tilla janë një pasuri e çmuar për kujtesën kombëtare.

Në emër të komunitetit të Selckës përshëndeti z. Eqerem Xhelili, i cili shprehu mirënjohjen për realizimin e kësaj monografie dhe për përkushtimin e autorit në dokumentimin e historisë së vendlindjes.

Një tjetër moment i veçantë i aktivitetit ishte interpretimi i Grupit Polifonik të Bashkisë Memaliaj, i cili solli për të pranishmit dy këngë me tekst të autorit Feti Zeneli, duke krijuar një atmosferë të ngrohtë dhe duke promovuar një nga vlerat më të spikatura të trashëgimisë sonë shpirtërore.

Në fjalën e tij përmbyllëse, autori Feti Zeneli falënderoi Shoqatën “Tafil Buzi”, të gjithë pjesëmarrësit dhe bashkëpunëtorët që kontribuan në realizimin e monografisë. Ai ndau me të pranishmit disa prej sfidave dhe motiveve që e shtynë të ndërmerre këtë punë shumëvjeçare, me synimin për të lënë një dëshmi të dokumentuar për historinë, traditat, figurat dhe vlerat e Selckës së Madhe.

Në shenjë mirënjohjeje dhe vlerësimi, Shoqata Atdhetare Kulturore “Tafil Buzi” akordoi disa certifikata me titullin “Nderi i Krahinës” për banorë të Selckës, të cilët me veprimtarinë dhe kontributin e tyre kanë lartësuar emrin dhe vlerat e kësaj treve.

Ceremonia u mbyll me një koktej miqësor, ku pjesëmarrësit patën rastin të uronin autorin, të shkëmbenin

vijon në faqen 8

NJË DEDIKIM MIRËNJOHËS NGA SHOQATA JONË PËR KONTRIBUTIN E ENKELEIDA FEJZOS NË DITËLINDJEN E SAJ

Vijon nga faqja 1

rëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomatieke”; Titulli: Drejtësi (Jurist), Titullin: Master Shkencor “E Drejta Publike Ndërkombëtare”, në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës.

Që nga krijimi i LNPSHA “PEGASI “ALBANIA është anëtare aktive e saj dhe në vitin 2017 është vlerëuar me titullin e lartë pegasian: “Poete - Veprimtare e Shquar e Shoqërisë Civile e vitit 2017”.

Që prej vitit 2001 ajo ushtron profesionin e lirë si gazetarë në fushën sociale në median e shkruar dhe vizive. Gjatë kësaj periudhe është kualifikuar dhe trajnuar, duke marrë mjaft vlerësime kombëtare dhe ndërkombëtare. “Sfidat aktuale dhe përgjegjësitë sociale në përballjen me proceset globalizuese”; Female Leadership”; Ndërmjetëse ligjore;

Certifikatë bamirësie nga shoqata “Martire të Policisë së Shtetit”

Kontribuese në pasurimin e bibliotekave dhe mirëmbajtjen e ambjeteve sociale në IEVP në Rep e Shqipërisë ku është certifikuar me titujt më të lartë vlerësimi.

Në 2025 u vlerësua me tit-

ullin e lartë në Brazil “Akademike e Pavdekshme”

Talenti i saj kreativ është shfaqur që në shkollën tetëvjeçare. Ka botuar në shtypin periodik: poezi, skica, tregime, reportazhe, shkrime problemore e tjerë si dhe ka përgatitur mjaft emisione televizive.

Si poete ka dy vëllime të botuara “KOHË E KEQE NË SHPIRT” është botuar në vitin 1998 nga Shoqata Botuese “VJOSA” Tepelenë. “DUET NË ETER” poezi (DUET IN ETHER), poemë, është libri i dytë i saj.

Për më shumë se dhjetë vjet është Presidente e Shoqatës “AlbAccess Open”. Me një kontribut të jashtëzakonshëm në hartimin dhe zbatimin e projekteve kulturore e sociale ku mund të themi se ka mbi 50 projekte që mbajnë autorinë saj.

Çfarë është Memaliaj për Enkeleidën?

Memaliaj është një qytet i vogël, por ka në prezencë të tij shumë veçanësi në shumatoren e njerëzve që janë rritur aty dhe kanë marrë drejtime në të gjithë botën.

Edhe unë ashtu si vetë synimi madhor për të cilin u ngrit ai qytet i dimensioneve të vog-

la nga pikëpamja hapësinore, përpiqem të shndërroj çdo hapësirë të madhe apo të vogël, ta kthej në një shërbim shpirtëror, dhe nuk kam pse ta fsheh, fal lindjes dhe banimit tim në atë qytet të vogël, ku banorët e të cilit patën një botë të admirueshme, më ka bërë që unë ta shndërroj në “kryefjalë”. TË JEM VET-VETJA!

Kësaj do t'i shtoja krenarinë time nga rrënjët e mia në gjithë dramacitetin jetësor të këtij qyteti, ku prirja kryesore e tyre ishte dhënie e kontributit në atë qytet, amaneti i gjyshërve të mi dhe tim ati; **ku duhet të bëshë vepra të mira, të ndihmohet njerëzit dhe të jesh mirënjohës ndaj të drejtës e të vërtetës.**

Këto fjalë ishin njësoj si pasurira dhe ekzistenca e shtresave nëntokësore të qymyrgurit. pra njerëzit, të cilët u inkuadruan në këtë qytet dhe u angazhuan me atë mineral të nevojshëm për jetesën e popullatës dhe më gjerë, u bënë njerëz me shpirt e zemër të madhe, kontribues të devotshëm, njerëz të sakrificave të cilët e donin qytetin e tyre të ri dhe minierën e tij... Natyrisht, mbi këtë bazë ekzistenciale u

rritën edhe njerëzit profesionistë... Aty u rrita dhe UNË.

Ju shpesh thoni se lindja në atë qytet ju ka dhënë edhe një bekim, a mund ta dimë cili është?

Qesh... po e them si bekim sepse unë rrënjët e mia nga babai i kam nga Dhemblani (Labëri) ndërsa nga mamaja i kam nga Zhapokika (Toskëri), kjo më ka ndihuar shumë në komunikim, histori, diplomaci në zakone e doke.

E për këtë kam pas fat, sepse orgjina ime më ka ndihmuar shumë, me pak fjalë kam ditur të veproj sipas vendit dhe kuvendit.

Ju jeni një vazjë shumë modeste por ne që të njohim e dimë se ti ke një zemër të madhe. Mund të tregoni pjesëmarrjen tuaj në komunitet dhe cilat janë ndërveprimet tuaja?

Faleminderit për pyetjen.

Po dhe për këtë ndihmë shumë krenare Jam marrë me letërsinë kur isha 17 vjeçe dhe më pëlqen shumë poezia e novela, besoj e kam të trashëguar nga gjyshi im Izet Fejzo.

Kjo me ka sjellë përfitim të edukohem dhe të takohem me shkrimtarë dhe gazetarë dhe

njohjen me shumë problem më njerëzit. për shkak të studimeve drejtimi im mori dhe atë të botimeve akademike, si në kërkime shkencore në fushën e edukimit.

Rolin më ta madhe e mbanë angazhimi im prej 2016 në Shoqatën “ALBACCESS OPEN” me qëllim: Avancimi i demokracisë për përparimin e shoqërisë civile, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe në shtete ku ka kombësi shqiptare kudo ndodhen. Ndërmjet bashkëpunimit efektiv me kapacitete institucionale qendrore, vendore, akademisë, komuniteteve.

Punoj në fushën e zhvillimit të bashkëpunimit dhe solidaritetit kombëtar dhe ndërkombëtar, si: fatkeqësitë natyrore, sëmundjet madhore, etj. që prekin shtetet ku ka kombësi shqiptare brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Kam kontribuar në nxitjen e studimeve, hulumtimeve, botimeve dhe aktiviteteve të ndryshme kulturore dhe aktivitete për minimizimin e dhunës, diskriminimit, korrupsionit, pabarazisë gjinore.

Ndihmoj dhe vazhdoj në

vijon në faqen 8

KOMARI – FSHATI KU ZEMRAT RRAHIN NJËSOJ PËR VENDLINDJEN

Vijon nga faqja 6

Kujtohen me nderim ata që nuk jetojnë më, ata që me djersën, ndershmërinë dhe punën e tyre ndërtuan historinë e Komarit dhe lanë pas emrin, traditën dhe dinjitetin e këtij



fshati. Festa u nderua edhe nga Kryetari i Bashkisë Memaliaj, Albert Malaj, si dhe nga administratorja e zonës, Dituri Koçiaj, të cilët iu bashkuan kësaj dite të veçantë të komunitetit komarjot. Prania e tyre

ishte një shenjë respekti për këtë bashkim të bukur njerëzor dhe për kontributin që banorët e Komarit vazhdojnë të japin për vendlindjen e tyre.

Mbrëmja vijoi me përshëndetje të ngrohta nga të ftuarit,

kryetari i Shoqatës Kulturore Atdhetare “Tafil Buzi”, biri i Komarit, Bashkim Brahimi. Fjala e tij ishte një thirrje zemre për bashkim, respekt dhe mirënjohje, një homazh për të parët tanë dhe një falënderim i singertë për çdo bashkëfshatar që u bë pjesë e kësaj nisme fisnike. Komari ka dëshmuar se nuk jeton vetëm me kujtimet e së shkuarës. Ai ndërton të ardhmen me duart dhe zemrat e njerëzve të tij. Një fshat nuk jeton vetëm me shtëpitë e tij. Ai jeton me kujtesën. Me historinë. Me njerëzit. Me sakrificat. Me dashurinë. Komari i ka të gjitha. Prandaj ai nuk është vetëm një fshat mes maleve. Ai është një simbol i unitetit, i fisnikërisë dhe i krenarisë toske.

Le të jetë Sheshi i Teqesë, një gur themeli për nisma të tjera. Le të mbetet Komari gjithmonë një fshat ku tradita ecën krah për krah me



zhvillimin, ku njerëzit janë pasuria më e madhe dhe ku dashuria për vendlindjen nuk njih kufij. “Takimi i brezave” nuk ishte thjesht një festë. Ishte një dëshmi se dashuria për vendlindjen nuk zbehet me kalimin e viteve dhe as me largësinë. Ishte dita kur malli u kthye në gëzim, nostalgjia në kujtim të gjallë dhe respekti për të parët në një amanet për brezat që do të vijnë.

Komari nuk matet me numrin e banorëve që kanë mbetur. Ai matet me zemrat që rrahin për të. Me kujtimet që nuk treten, me dashurinë që nuk shuhet dhe me besimin se, pavarësisht se ku i çon jeta bijtë e tij, rrënjët mbeten gjithmonë në këtë tokë të bekuar. Sepse atdheu fillon nga fshati yt.

E kur fshati quhet Komar, krenaria bëhet edhe më e madhe.

PROMOVHET MONOGRAFIA “KOPSHTINA JONË – SELCKA E MADHE”, NJË VEPËR QË I SHËRBEN HISTORISË DHE IDENTITETIT TË KRAHINËS

Vijon nga faqja 7

mendime dhe të forconin lidhjet e bashkëpunimit për nisma të tjera kulturore. Falnderim i veçan për moderatorin e talentuar z Albert Zholi

Ky promovim nuk ishte thjesht prezantimi i një libri, por një homazh për kujtesën historike, për njerëzit që e kanë ndërtuar me punën dhe sakrificat e tyre këtë krahinë, si edhe një dëshmi se ruajtja e historisë dhe e identitetit mbetet një detyrë e përhershme për çdo brez. Monografia “Kopshtina jonë – Selcka e Madhe”

vjen si një pasuri e çmuar në fondin e botimeve historike shqiptare dhe



si një trashëgimi e vyer për brezat që do të vijnë. Kujdesi që shoqata jonë tregoi në promovimin e këtij libri

është dëshmia më e plotë, më e qartë dhe më domethënëse se shoqata jonë



nuk do të rreshtë kurrë në evidentimin e vlerave tona e kështu ajo do të jetë gjithnjë e gatshme të sjellë në për-

ditshmërinë e saj edhe libra të tjerë që krijuesit tanë shkruajnë duke sjellë



në faqet e tyre të djeshmen, njerëzit tanë, duke sjellë vlerat tona kulturore, njerëzore dhe artistike.

Vijon nga faqja 7

ngritjen e shërbimeve dhe qendrave edukative-sociale. Ofroj këshillime edukuese në shërbimet e mësipërme në çdo njësi vendore dhe qendrore.

Gjithëpërfshirëse në Institucione shkollore, Qendra Rinore, Qendra Rehabilitimi.

Koherente me komunitetet botërore të mendimit të specializuar.

Marrë pjesë në trajnime në shumë fusha të ndryshme brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

Jam vlerësuar nga shumë institucione për kontribute humane dhe ko më bënë akoma më shumë të mos ndryshoj.

Të gjitha këto nisma nuk bëhen vetëm, por unë çdo ditë falenderoj dhe jam mirënjohëse të gjithë atyre që më janë bashkuar në veprat e mira.

Këtu dua të falenderoj edhe shoqatën “Tafil Buzi”



NJË DEDIKIM MIRËNJOHËS NGA SHOQATA JONË PËR KONTRIBUTIN E ENKELEIDA FEJZOS NË DITËLINDJEN E SAJ

Së fundi a keni një mesazh ?

Do përpiqem t'i bëjë bashkë disa mesazhe në një të vetëm.

– Mendoj se e vërteta duhet përsëritur shpesh pasi shpesh përsëritet edhe gënjeshtria. Mirë është që të kemi miq të zgjuar, por pse jo të kemi miq dhe “armi” të mençur. Dhe së fundi mirë është që mos t'i numërosh kurrë vitet që ikin dhe t'i shumëzosh orët e ardhshme. Ky mesazh besoj se do t'i bëjë mirë çdo qytetari!

Qesh....

dhe Qendra “Rreze Drite Sinani” që vetëm në vitin e kaluar së bashku ne kemi bërë më shumë se 6 aktivitete kushtuar moshës së tretë, shkollave e fëmijëve më aftësi ndryshe.

Dhe mirëpresë këdo e cilindo për bashkëpunime; të bëjmë vepra e punë të mira.

Gjirokastër, Lavdi Hasani, Altin Goxhaj
Ksamil, Resul Pushi, Neim Murto
Berat, Ferdinand Mimani, Syrja Kalem
Tiranë, Feti Zeneli, Roshi Ajdini,
Hava Mhasi Muçollari
Sarandë, Medi Kalem

Gazeta
“Trebeshtina”
Kryeredaktori,
Veledin_Durmishi@yahoo.com
Marketing: Asim BRAHIMI

Bashkëpunëtorët tanë në rrethe:
Delvinë, Fatmir Pushi
Durrës, Besnik Hoxha
Tepelenë, Bedri Serjani, Gëzim G. Ajdini,
Gëzim Q. Ajdini